

BASHKIA BULQIZE

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT 2008 - 2013



PLANI I ZHVILLIMIT LOKAL BULQIZË 2008-2013

AUTOR:

Bashkia Bulqizë, nën mbështetjen e
"Njësise Trajnuese"

PROCESI U DREJTUA NGA:

Roland KETA
Naim GAZIDEDE
Greg BOOTH

BASHKËPUNUAN:

Administrata e bashkisë, Nën/Prefektura
Bulqizë, Qendra Kulturore, Zyra e Arsimit,
Shërbimi Parësor dhe Spital, Drejtoria e
Tatim Taksave, Drejtoria e Albtelekomit,
shoqëria civile etj.

SI DHE:

Miranda Kurti, Nafie Jella, Hamit Dervishi,
Florina Brata, Blerina Alla, Natasha Gjoka,
Gezim Boba, Adelina Kazanxhiu, Jorgo
Kola, Valbona (Musa) Vladi, Artan Lami,
Sulejman Alia, Gezim Hoxha, Xhemile Duva,
Ariana Tançi, Bashkim Novaku, Agim Boba
(anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane
të Shkencave Në York) etj.

LEHTËSUES I PROCESIT:

Z. Mehmeti, R. Hoxha, P. Përnezha
(Njësia Trajnuese) dhe N. Mazari, B.
Alku (SNV-Peshkopi)

Për më shumë informacion:

Bashkia Bulqizë
Tel&Fax 02192696
Email: rolandketa@hotmail.com

Këshilli i Qarkut Dibër
Tel&Fax: 02182324,
pajtim71@yahoo.com

Njësia Trajnuese Tel:02182170
njesiatrajnuese@yahoo.com

SNV-Peshkopi Tel dhe Fax:02182642
nmazari@snv.al.eu.org

Design & Press
"M&B" - Botime & Studio Grafike
(04) 2 233 283, mbsotime@gmail.com

PËRMBAJTJA

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR BASHKINË BULQIZË	4
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROFILIN E BASHKISË	
Popullsia	7
Pozita gjeografike	7
Historia	8
Arsimimi dhe burimet njerëzore	9
Kultura dhe besimi fetar	9
Organika e Bashkisë Bulqizë	9
I. ZHVILLIMI EKONOMIK	9
Bujqësia	11
Blegtoria	11
II. SHËRBBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA	12
Uji i pijshëm	12
Kanalizimi i ujërave të zeza	13
Kanalizimi i ujërave të bardha	13
Mbetjet urbane	14
Shërbimet e tjera	14
III. ZHVILLIMI SOCIAL	14
Problemet dhe zhvillimi i arsimit	14
Problemet dhe zhvillimi i kulturës & sporteve	15
Problemet dhe zhvillimi i shëndetësisë	15
Burimet natyrore	16
KROMI	16
IV. QEVERISJA E MIRË	17
Qendra e informimit publik	17
Qendra kulturore	17
Prioritetet e procesit	18
FUSHA PRIORITARE:	
Zhvillimi Ekonomik	19
Infrastruktura / Shërbimet publike	23
Zhvillimi social	28
Qeverisja e mirë	33

*N*ë cilësinë e kryetarit të bashkisë Bulqizë dëshiroj të falënderoj mbështetësit e procesit të hartimit të planit të zhvillimit lokal të qytetit të Bulqizës, Këshillin e Qarkut Dibrë dhe Organizatën Hollandeze për Zhvillim SNV-Peshkopi, që nëpërmjet “Njësise Trajnuese”, kontribuan fuqishëm për realizimin e dokumentit kryesor të së ardhmes së bashkisë.

Plani i Zhvillimit Lokal, në momentin e duhur të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e social, përbën në vetvete një sistem drejtimi universal, gjithëpërfshires, orientues për të ecur me hapat e sigurt drejt Bulqizës së të nesërmes.

Plani i zhvillimit lokal do të ishte i cunguar nëse do të realizohej brenda mureve të administratës së bashkisë, ndaj dhe ne qëllimisht jemi munduar të përfshijmë sa më shumë aktorë, sa më shumë grupe, për ta parë të ardhmen në disa këndvështrime, të cilat rezultuan me objektivitet të plotë.

Falënderojme grupet e interesit, përfaqësuesit e arsimit, shëndetësisë, të ujësjellësit, të tatim taksave, shoqërisë civile, që me ndihmën e tyre bënë të mundur krijimin e profilit real të Bulqizës së re.

Falënderojme intelektualët për mendimet e dhëna, mendime të cilat shërbyen si udhërrëfyese drejt Bulqizës së të nesërmes.

Vizioni i gdhendur në faqet e këtij plani “Bulqiza, do të jetë një qytet me infrastrukturë bashkëkohore, me njerëz të arsimuar dhe të shëndetshëm, me ekonomi të zhvilluar e shërbime cilësore, me komunitet të punësuar e me mundësi argëtimi dhe turizmi”, përmbledh në vetvete qëllimin e orientimeve tona, qëllimin për të realizuar një të ardhme të përbashkët.

Vizioni përbën në vetvete një detyrim për t’i ndjekur dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për ndërtimin e një qyteti, ku fëmijët tanë ta ndiejnë veten të sigurt.

Duke përfunduar, ju uroj të gjithëve përfundimin me sukses të këtij plan zhvillimi.

Me respekt,

Kryetari i Bashkisë
Roland KEJA



KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

Bulqiza, kryeqendra e rrethit Bulqizë shtrihet në pjesën jug-perëndimore dhe kufizohet nga: në lindje Komuna Zerqan dhe Ostren, në jug nga Komuna Martanesh, në veri nga Komuna Fushë-Bulqizë dhe në Perëndim nga kufiri administrativ i rrethit Mat. Në një sipërfaqe urbane 0.6 km² dhe sipërfaqe administrative 45.6 km², e cila përbën 6.26 % të sipërfaqes së përgjithshme të rrethit Bulqizë prej 728 km², ku banojnë 12711 banorë, të organizuar në tre lagje të qytetit (L.e Re, L.Gjeologu, L.Minatori) dhe dy fshatra (Vajkal 1 dhe Vajkal 2). Nga këto 8.8% jetojnë në fshat, ndërsa 91.2% në tre lagjet e qytetit.

Burimet e konsiderueshme njerëzore e natyrore të bashkisë, të përmendura vetëm pjesërisht në parashtrimin e mëposhtëm, mundësojnë plotësisht një zhvillim të qëndrueshëm të kësaj njësie. Sot ajo po përfshihet natyrshëm e me vullnet në procesin e demokratizimit të përgjithshëm të jetës së vendit dhe në rrugën e zhvillimit të ekonomisë së tregut e të rritjes së mirëqenies.

Ku jemi?

Administrata e Bashkisë Bulqizë, mbështetur nga Këshilli i Qarkut Dibër SNV- Peshkopi, arritën që në fazën e parë të procesit të bëjnë të mundur evidentimin e gjithë situatës aktuale të kësaj njësie. Në këtë fazë u grumbulluan të dhënat e duhura sipas drejtimeve dhe grupeve të ngritura në një periudhë 6 javore, të dhëna të cilat do të jenë objekti i analizimeve të mëtejshme dhe evidentimi i dobësive të kësaj njësie.

Qëllimi i përgjithshëm i të gjithë stafit konsiston në një analizë SWOT me të gjithë parametrat e duhura, ndaj dhe ne jemi përqendruar në informacionin e grupeve të procesit.

Zhvillimi aktual ekonomik i bashkisë përfshin disa drejtime e aspekte kryesore:

- ❖ **Miniera e kromit**
- ❖ **Fabrika e pasurimit të kromit**
- ❖ **Turizmi familjar dhe ai i objekteve të kultit**
- ❖ **Zhvillim i blegtorisë dhe i bujqësisë**
- ❖ **Organizim dhe marketing në drejtim të mbledhjes së bimëve medicinale**
- ❖ **Ngritja dhe fuqizimi i tregut**
- ❖ **Ngritja e bizneseve të vogla përpunuese**
- ❖ **Përmirësimi i mjedisit**

Stafi i Bashkisë, këshilli i saj dhe kryetarët e lagjeve dhe fshatit Vajkal, nëpërmjet aftësisë në rritje të tyre, po shtojnë kapacitetet zhvilluese të njësisë. Ata jo vetëm po e bëjnë Bashkinë e tyre pjesë të strategjisë të zhvillimit të rajonit të Dibrës, por hartuan dhe Planin lokal të zhvillimit të bashkisë, duke çelur një perspektivë të re zhvillimi.

1. Pse duhet të hartohet plani i Bashkisë?

Plani i zhvillimit lokal është një dokument i së ardhmes, i hartuar nga të gjithë aktorët vendorë dhe që krijon mundësinë e planifikimit, zbatimit dhe kontrollit të zhvillimit ekonomik dhe social në të ardhmen. Një plan i zhvillimit lokal kur është atribut vetëm i administratës ka pak gjasa të jetë gjithëpërfshirës, ndërsa një proces me pjesëmarrjen e komunitetit është produktiv dhe angazhues për të gjithë komunitetin dhe drejtuesit e tyre.

Të gjithë njësitë vendore kanë një objektiv të përgjithshëm, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve, ndërsa duke i trajtuar këto si objektiva konkrete të dokumentuara në PZHL të Bashkisë, përbëjnë prioritete të padiskutueshme dhe ofrohen alternativa për arritje të suksesshme.

2. Për një vizion të përbashkët

Në botëkuptimin e gjithësecilit gjendet një ide imagjinare e bashkisë së të nesërme, e një bashkie europiane, e një infrastrukture bashkëkohore dhe me mundësi të mëdha të komunitetit për të jetuar në kushte komode. Detyra jonë është të ofrojmë imagjinatën e gjithkujt në një mendim të përgjithshëm vizionar, nga ku do të përcaktohen saktë rrugët e suksesit të së ardhmes.





3. Një plan për të ardhmen

E ardhmja jonë sigurisht që do të ndryshojë me hapat e kohës. Ne duhet të jemi pjesëtarë dhe aktorë të këtij ndryshimi, ne duhet të përshpetojmë këtë ndryshim, ne duhet të gdhendim në historinë e këtij qyteti ndryshimin e madh, të përpiqemi që me mendimet tona të dokumentojmë një plan për të ardhmen e sigurt.

4. Katër shtyllat kryesore

- A-Zhvillimi ekonomik;
- B-Zhvillimi i infrastruktures dhe shërbimeve;
- C-Zhvillimi social;
- D-Qeverisja e mirë.

5. Një komunitet shumë zëra


Do të ishte shumë e lehtë të hartonim një dokument zhvillimi të ngjuar në zyrat e bashkisë, dokument të cilin pakkush do të kishte dëgjuar dhe ku mendimi i komunitetit nuk do të kishte vend në proceset e ardhshme të zhvillimit. Në metodologjinë e procesit të hartimit të planit të zhvillimit lokal për bashkinë Bulqizë termi “gjithëpërfshirës” nënkupton përfshirjen e të gjithë aktorëve në dhënien e mendimit për të ardhmen e njësisë së tyre. Grupet e biznesit, grupet qytetare, të rinjtë, gratë, intelektualët, administrata të ndryshme, grupet e lëna në harresë janë të përfshira dhe e gjejnë veten lehtësisht të përfshirë në këtë proces. Shumë zëra të këtij komuniteti janë të përfaqësuar në një drejtim të zhvillimit të njësisë së tyre.

6. Komunikimi me publikun

Komunikimi me publikun është realizuar në shumë forma. Pyetësorët, si një metodë klasike për të marrë mendimin e pavarur dhe vlerësimin për shërbimet e deritanishme, takimet në çdo lagje për prezantimin e programit dhe thithjen e mendimit të tyre janë format e menduara për të komunikuar me komunitetin e gjerë.

7. Kush u përfshi në planin e zhvillimit (diagrama e procesit)

Për të pasur një proces të hapur dhe transparent, metodologjikisht është menduar përfshirja sa më e gjerë e aktorëve lokal nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës. Grupet kryesore: Grupi i Planit të Zhvillimit të Bashkisë i përbërë nga Kryetari, N/Kryetari, përfaqësues të zyrave të bashkisë, përfaqësues të Këshillit bashkiak, Përfaqësues të shoqërisë civile. Përgjithësisht diagrama e procesit paraqitet si më poshtë:



8. Si e realizuam procesin? Njëmbëdhjetë hapat për hartimin e Planit

1. Garantimi i angazhimit lokal

Ky hap, si një nga hapat kryesorë, siguron që përfaqësuesit e zgjedhur të bashkisë, pasi të njihen me programin, metodologjinë, të shprehin vullnetin për ndjekjen dhe realizimin e tij në të gjithë etapat e duhura.

2. Ofrimi i Asistencës

Këshilli i Qarkut Dibër, nëpërmjet “Njesisë Trajnuese” nën mbështetjen e SNV-së Peshkopi, nëpërmjet trajnimeve të anëtarëve të grupit, duke u mbështetur në metodologjinë e procesit ka ofruar asistencën për grupin kryesor dhe nëngrupet e drejtimeve kryesore të zhvillimit, për të bërë të mundur realizimin dhe përfundimin e procesit me sukses të plotë.

3. Fillimi i punës

Sipas planit të punës të miratuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë, janë detajuar në aktivitete konkrete mujore të gjitha hapat e procesit, me afatet kohore dhe janë përcaktuar detyrat për çdo nënstrukturë që do të përfshihet në program.

4. Mbledhja e informacionit

Nëpërmjet këtij hapi është bërë i mundur



realizimi i vlerësimit të situatës “ku jemi”, në mënyrë që të krijohet një mendim i përgjithshëm dhe një pamje e saktë për të bërë të mundur analizimin e mëtejshëm. Kjo fazë rezultoi të jetë një nga fazat më të ngjeshura të procesit, ku përfshirja e shumë aktorëve dhe personave “kyç” në sigurimin e të dhënave rezultoi pozitive. Vlen të përmendet fakti se është bërë një punë voluminoze në realizimin e pyetësorit, me një intensitet rreth 15 %, ç’ka dëshmon për një përfshirje të gjerë në dhënien e mendimeve për situatën aktuale. Referuar informacionit të grumbulluar është hartuar projekt-drafti i profilit të përgjithshëm të bashkisë dhe, duke iu referuar të dhënave të grumbulluara, është bërë i mundur analizimi i pikave të dobëta, të forta, risqeve dhe mundësive të kësaj njësie. (Analiza SWOT)

5. Takimet në komunitet

Grupi i punës ka përdorur një sërë mundësish për të marrë mendimin e komunitetit për të ardhmen e tyre. Takimi më kryesor me rreth 120 pjesëmarrës, përfaqësues të të gjithë drejtorive, grupeve të interesit dhe pjesëtarëve të komunitetit është zhvilluar në Qendrën Kulturore, ku pjesëmarrësit shprehën mendimet e tyre dhe orientimet strategjike për Bulqizën e së nesërme.

6. Sintetizimi i të dhënave

Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm dhe mendimit qytetar, sipas manualit të veprimit nga grupi i punës u përcaktua vizioni dhe hapat

e veprimit për orientimet e zhvillimit strategjik. Në mënyrë të përgjithshme u rreshtuan prioritetet e zhvillimit sipas drejtimeve dhe shtyllave kryesore të hartimit të këtij plani, të cilat do të ishin objekt i vlerësimit të komunitetit në takimin e ardhshëm.

7. Marrja e mendimit të komunitetit

Komuniteti, por dhe përfaqësues të institucioneve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bashkinë Bulqizë, nëpërmjet procesit të vlerësimit të prioritetëve, dhanë ndihmesën e tyre në përcaktimin e radhës së implementimit të kësaj strategjie. Rezultatet e këtij procesi janë të publikuara në tabelat e objektivave strategjike në fund të këtij dokumenti.

8. Integrimi në procesin e buxhetit

Mbetet detyrë e stafit të bashkisë, që këtë dokument ta integrojë në procesin e buxhetimit të brendshëm. Objektet dhe prioritetet e këtij plani përbejnë në vetvete detyrimin e stafit të kësaj njësie për zbatimin e objektivave nga buxheti i brendshëm, si dhe të kërkojnë rrugët dhe mundësitë për realizimin e saj brenda afatit pesëvjeçar 2008-2013.

9. Monitorim-vlerësimi i vazhdueshëm

Procesi i monitorimit të implementimit dhe zbatimit të Planit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë Bulqizë do të jetë objekt i vazhdueshëm pune i stafit të saj, i këshillit bashkiak, por dhe i komunitetit në tërësi. Për një monitorim cilësor do të ishte e udhës realizimi i këtij procesi nëpërmjet shoqatave apo organizatave që ushtrojnë aktivitetin në Bulqizë dhe që kanë përvojën e duhur në këtë fushë.

10. Afatet kohore të realizimit të procesit

I tërë procesi nga grupi i punës, referuar programit të punës për realizimin e “Planit të Zhvillimit Lokal të Bashkisë Bulqizë”, është menduar të realizohet për një periudhë 7 (shtatë) mujore dhe në fund të kësaj periudhe që përkon me muajin dhjetor të këtij viti, do të bëhet i mundur publikimi dhe botimi i këtij dokumenti.

11. Afatet kohore të implementimit të planit

Nga grupi i punës, me qëllim realizimin e një plani ambicioz dhe të zbatueshëm, është menduar për një afat kohor të implementimit të tij 5 (pesë) vjeçar. Herë pas here grupi i punës, duke u nisur nga përvoja e fituar tashmë, do të përmirësojë dokumentin me objektiva të rinj dhe objekte konkrete për të bërë të mundur krijimin e hapësirave për një zhvillim të qëndrueshem ekonomik dhe social.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROFILIN E BASHKISË

POPULLSIA

Bashkia Bulqizë ka një popullsi me 12711 banorë, ku sipas statistikave të marra pranë zyrës së gjendjes civile, 48.08% e tyre përbëhet nga femrat. Referuar natyrës dhe punësimit që të ofron qyteti, popullsia është heterogjene dhe kjo ka ardhur si rezultat i popullimit në rritje në kohën e ish-diktaturës. Nga rrethi i Dibrës si dhe nga fshatrat e rrethit të Bulqizës ka pasur një dyndje të konsiderueshme në drejtim të këtij qyteti, që në trevën e verilindjes njihet me emrin “qyteti i minatorëve”.

Aktiviteti i nxjerrjes dhe përpunimit të kromit është shoqëruar historikisht me ardhjen e specialisteve, kryesisht të gjeologjisë dhe të minierave nga i gjithë vendi, çfarë dëshmon qartë për një shkallë intelektualiteti dhe qytetërimi konstant të kësaj njësie. Shumica e popullsisë janë të besimit mysliman, bektashinj (kryesisht autoktonët dhe të fshatrave të rrethit Bulqizë) dhe një pakicë tepër e vogël e besimeve të tjera. Vihet re një shkallë e madhe respekti ndaj besimit të njëri-tjetrit, dhe shquhet në vetvete si një zonë ku të gjithë respektojnë objektet fetare të famshme për këtë rreth.

Pas viteve 1990-1992, si rezultat dhe i ndryshimeve të ardhura nga tranzicioni që përshkoi tërë Shqipërinë, Bulqiza është përballur me një sërë problemesh, të cilat për 14-16 vite kanë shoqëruar këtë komunitet të lënë në harresë.

Greqi, Itali dhe Angli. Të ardhurat vjetore nga emigracioni për familjet e tyre llogaritet përafërsisht në masën 1.474.000 Euro, të ardhura këto që shkojnë në drejtim të ekonomive familjare dhe shumë pak në krijimin e mundësisë së hapjes së bizneseve të reja, duke krijuar një vakum në drejtim të investimeve private në vend, të cilat nxisin zhvillimin dhe forcojnë infrastrukturën.



POZITA GJEOGRAFIKE

Bashkia Bulqizë shtrihet në verilindje të Shqipërisë, në koordinatat 41°49"/ 20° 23" dhe kufizohet nga njësitë vendore Komuna

Martanesh, Komuna Fushë-Bulqizë, Komuna Zerqan dhe rrethi Mat. Gjeografikisht është vendosur në luginën e përroit të Vajkalit në një lartësi 700-1100 m mbi nivelin

Nr	Lagjia/Fshati	Banorë Gjithsej	Popullsia			Pensionistë	Familje	
			Qytet	Fshat	Femra		Fshat	Qytet
1	2002	16565	15442	1123	8170	–	329	3717
2	2005	13438	12298	1140	6485	–	313	3221
3	2006	12851	11719	1132	6202	–	309	3127
4	2007	12711	11587	1124	6112	3600	307	3125
Bashkia						3600		

Në tabelën e mësipërme vihet re një kristalizim i popullsisë dhe nga viti në vit lëvizjet në drejtim të zonave të ulëta po frenohet. Në uljen e numrit të popullsisë ka ndikuar migrimi i saj në drejtim të Tiranës, Durrësit dhe kjo për arsye: ndryshimi strukturor i tranzicionit, zhvillimi i pakët i sektorit privat, shkëmbimeve rajonale të pakta ekonomike, mungesa e masave nxitëse pothuajse në të gjitha drejtimet. Emigracioni, si në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore të Shqipërisë, edhe në këtë njësi është i madh. Sot, sipas informacionit të marrë nga Zyra e Punës, rezulton se rreth 737 emigrantë punojnë dhe jetojnë jashtë vendit, kryesisht në

e detit. Bashkia Bulqizë është qendra administrative e rrethit Bulqizë, ku janë vendosur institucionet më të rëndësishme shtetërore të këtij rrethi si: Prokuroria, Gjykata, Dega e Tatim Taksave, Sigurimet Shoqërore, Drejtoria e Pyjeve, Shëndeti Publik, Shërbimi Gjeologjik, si dhe zyra të rëndësishme të rrethit.

Bashkia Bulqizë është njësi administrative e qarkut të Dibrës. Ajo shtrihet në verilindje të Shqipërisë, në një distancë prej 128 km nga Tirana dhe 50 km nga qendra administrative e qarkut Dibër, Peshkopi. Ka një sipërfaqe të përgjithshme 45.6 km².



HISTORIA

Bulqiza, si një trevë e hershme njihet që në epokën e gurit, e cila i përket një periudhe relativisht të largët 6000-7000 vjeçare. Gjatë kësaj periudhe kjo zonë popullohet nga fiset ilire, ku më të përmendur ishin Penestët me kryevend Uskanën. Në kohërat e dyndjeve barbare sllave, në fushën e kalasë u zhvilluan luftime të përgjakshme kundër pushtuesve, të cilët dogjën dhe plaçkitën qytetin me emrin Vali(os). Qyteti në fjalë shtrihej në të dy anët e urës se sotme të qytetit, aty ku lartësohet shkëmbi i Skënderbeut. Si rezultat i këtij pushtimi dhe djegie, por dhe të atyre të mëvonshme, populli u detyrua të largohej nga trojet e tij dhe të vendosej rrëzë maleve dhe kodrinave të luginës së Bulqizës si në fushëgropë, Dushe e Koçej.

Qyteti i Vali-t(osit) pati një zhvillim të madh në drejtim të tregtisë, bujqësisë dhe blegtorisë. Si rezultat i zhvillimit dhe fuqizimit ekonomik, popullsia e këtij qyteti shtohet me ritme të shpejta, duke u bërë një nga qendrat më të mëdha asokohe të Ilirisë.

Në arkivat e deritanishme, emri “Bulqizë” është hasur në defterin turk të vitit 1467 dhe sipas tij Dibra e Poshtme kishte 56 vendbanime, ndërsa Dibra e Epërme 53 të tilla. Në këtë kohë flitej për dy nëndarjet tradicionale të Dibrës. Në fund të pushtimit osman, malësia e Dibrës ishte e ndarë në nëntë bashkësi krahinore ose siç quhen ndryshe “nëntë malet e Dibrës”, dhe Bulqiza ishte pjesë e tyre. Bulqiza u be e njohur me betejën e famshme dhe historike të Vajkalit. Meqë jemi te betejat, këtu ka vend për të diskutuar për vendzhvillimin e tyre, sepse ka edhe paqartësira. Marin Barleti e lë të papërcaktuar

vendin e saktë se ku u zhvilluan mjaft beteja e sidomos betejat e zhvilluara në dy Dibrat. Ai mjaftohet duke thënë se kjo ose ajo betejë u zhvillua në Dibrën e Sipërme apo të Poshtme. Një fenomen i tillë shfaqet që në betejën e parë, ku ai shkruan se ajo u zhvillua në Dibrën e Poshtme, 80 mijë hapa larg Krujës, në një kodrinë të mbuluar me ferra ose më drejt, pranë një pylli plot me drunj shumë të dendur. Fusha e Tervjollit e kish marrë këtë emër ngaqë ka shumë vullë për rreth, sepse populli e thirr edhe me një emër tjetër: Fusha e Kalasë. Siç duket, emrin Fusha T'Vollt është emër i dytë, që e mori pasi u shkatërrua nga sllavët në shekullin e 7-të qyteti Vali (Valos) dhe në gërmadhat e tij mbinë shumë vullë, të cilat bëjnë fruta mjaft të shijshme. Ndërsa populli i Bulqizës e kujton këtë betejë nëpërmjet vargjeve të këngës: “Prej Terviollë n’Qafë Petralba, Gjith Terviolla n’gjak asht la, Me xhenaze mbush kala, Një pllamë tokë pa t’vdek nuk ka”. Siç shohim nga vargu i parë “prej Terviollë n’Qafë Petralba” (Petralba është Guri i Bardhë dhe Plani i Bardhë në Mat, ndërsa në atë kohë për hir të qytetit është quajtur e gjithë zona Petralba, ndërsa qafë Petralba është Qafa e Bullit, e cila ndan Matin me Bulqizën). Nga këto vargje që na vijnë nëpërmjet popullit të Bulqizës, meqë Petralba dhe Bulqiza janë zona kufitare, provojnë se beteja e parë u bë në këtë vend. Sipas tregimit nga të vjetërit thuhet se Skenderbeu u zuri pusi turqëve, por u diktua prej tyre dhe e rrethuan, duke menduar se do t’i mbarohet ushqimi dhe do të dorëzohet. Por Skënderbeu mblodhi grurin që kishin në torba ushtarët dhe ia dha ta haje një pele të bardhë dhe, pasi e ngopi mirë e mire, e rrëzoi nga maja e malit që bie thikë mbi rrugë. Kur i plasi stomaku kafshës turqit panë vetëm grurë dhe nga habia pyetën njëri-tjetrin: “Çfarë është kjo, pelë apo dhi? Nga ky rast fshati që ndodhet aty mori emrin Peladhi. Për sa i përket emrit Vajkal, një njohës i mirë i historikut të këtij fshati, Mustafa Mira, tregonte se: “Në luftë e sipër me turqit, kali i Skënderbeut u godit për vdekje dhe, ngaqë i erdhi shume keq për fatin e kalit, Skënderbeu thirri: vaj-kali. Nga ky moment vendi mori emrin Vajkal. Këtë ngjarje të njëjtë na e përshkruan edhe një bashkohës tjetër i Skënderbeut, humanisti i shquar Dhimitër Frangu, por edhe ky i fundit nuk e emërton vendin. Pra, këtu del qartë se deri në këtë betejë ky vend nuk quhej Vajkal dhe populli pas vrasjes së kalit të kryetrimt e pagëzoi këtë vend me emrin Vajkal. Mesa duket Barleti dhe Frangu nuk e patën këtë dëshmi. Kjo vjen se ato shkruajtën pas disa dekadash dhe si rrjedhim ka dhe mospërputhje, siç ndodh edhe me data dhe vendngjarje të ndryshme, të pandriçuara

mirë. Por këtu, siç duket, çorientimi i Barletit vjen edhe nga një fshat tjetër që ndodhet 8 kilometër në lindje të Vajkalit, në brinjë të Fushës së Tërviollit, me emrin Valikardhë. Ky fshat e mori këtë emër, pasi u dogj nga sllavët gjatë dyndjes së tyre, i qytetit Vali. Pas shkatërrimit të qytetit, banorët e tij u shpërndanë dhe krijuan vendbanime të reja si: Valikardhë, nga Vali-kardhë si banorë të ardhur nga Vali, Dushaj, Koçaj, Qyraj, Vali- i Martaneshit nga Vali-mat-an-nesh, të ardhur nga ana tjetër prandaj u quajt Martanesh etj.

ARSIMIMI DHE BURIMET NJERËZORE

Dendësia e popullsisë është 96 banorë/km². Raporti i shpërndarjes së popullsisë qytet fshat është: 4% banojnë në qytet dhe 96% banojnë në fshat. Niveli arsimor paraqitet në raport me popullsinë si më poshtë: me arsim të lartë mbi 6%, me arsim të mesëm 21%

KULTURA DHE BESIMI FETAR


Objektet fetare dhe të kultit: Referuar besimit autokton të kësaj treve, më të pranishme janë objektet e kultit të fesë bektashi. “Tylbet”, si vende dhe objekte të shenjta, respektohet nga i gjithë komuniteti i kësaj njësie, pavarësisht besimit të tyre. Është për t’u theksuar rasti i respektimit të besimit fetar të njëri-tjetrit dhe kjo zonë është një simbol i tolerancës fetare, një simbol i bashkëjetesës ndërfaqetare. Brenda territorit administrativ të Bashkisë Bulqizë ndodhen tylbet e: “Nënë Selvisë”, “Sheh Myslimit”, “Dede Mani”, “Dede Llorës” dhe “Dede Begut”. Gjithashtu, në Lagjen e Re është ndërtuar dhe funksionon Xhamia e Qytetit për besimtarët islamë.



ORGANIGRAMA

Organika e Bashkisë Bulqizë

Në organikën e vet administrata e bashkisë Bulqizë numëron 32 punonjës, ku 35 % të tyre e përbëjnë femrat. Më poshtë janë të ilustruar dhe të ndarë sipas sektorëve:



Përbërja e Këshillit të Bashkisë e ndarë sipas komisioneve ekzistuese: Komisioni i Verifikimit të Mandateve, Komisioni i Ekonomisë dhe Financës, Komisioni i Shërbimit dhe Emergjencave, Komisioni i Arsim-Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

I. ZHVILLIMI EKONOMIK

Referuar tabelës së krahasimit të të ardhurave të vitit 2006 në vitin buxhetor 2007 rezulton se parashikimi në vitin 2007 është në vlerë absolute më i vogël 879. Ndryshimi është tek “të ardhurat e tjera”, të cilat janë parashikuar në masën 61.7% të realizimit të vitit 2006.

Buxheti i Bashkisë për vitin 2007 është 76.259.000 lekë, prej të cilit pjesën dërrmuese e kapin shpenzimet operative.

PUNËSIMI: Nga popullsia aktuale, afërsisht 60% përfaqësojnë popullsinë aktive për punë të grupmohës 18-60 vjeç. Rreth 530 punëtorë janë përfshirë në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të kromit, të cilët përbëjnë një ndihmë për ekonominë e tyre familjare.

Të ardhurat e Njësisë për vitin fiskal 2006 dhe ato të parashikuara për 2007

Emërtimi	Totali i të ardhurave në 2006	% që shkon në komunë	Parashikim 2007
I. TË ARDHURA NGA TAKSAT			
1. Taksë mbi pasurinë e paluajtshme	953	100	1125
2. Taksa mbi biznesin e vogël	4949	100	4952
A) Taksa vendore mbi biznesin e vogël	900	100	1350
3. Taksa për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve të transp.	779	100	800
SHUMA I 7581 100 8227			
I. Tarifa			
a) Tarifa për shërbime publike	576	100	583
b) Dhënie e licensave, leje, autorizime e dok. të tjera	288	100	302
2. Të ardhura të tjera	5103	100	3150
3. Pagesa			
a) Të prindërve për kopshtet e fëmijëve	302	100	384
b) Të prindërve për çerdhet e fëmijëve	389	100	452
c) Të tjera	450	100	712
SHUMA II 7108			5583
TOTALI (I + II + III + IV + V)	14689	100	13810

Bizneset. Në Bashkinë Bulqizë numërohen rreth 220 biznese të regjistruara, ku nga këto 40 janë biznese të mëdha. Bizneset ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën urbane dhe vetëm katër prej tyre në fshatin Vajkal. Nga veprimtaria e tyre bashkia siguron rreth 13 milionë lekë të ardhura në vit. Bizneset, kryesisht kryejnë aktivitete shërbimi, ku më të përqendruar janë baret, kafenetë, restorantet, pikat e shitjes me pakicë si dhe serviset e tjera.


Të ardhurat

Të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë (në mijë lekë)

Nr	Viti	Transfertanga B.Shtetit	Fonde të kushtëzuara nga ministr	Të ardhurat	Donatorët	Totali
	2003	22612	74840	17376	000	114828
	2004	38207	93932	17169	20.000	149308
	2005	33410	103145	14635	19.000	151190
	2006	61875	154909	14689	18.000	229934
	2007	60217	155383	16042	000	231642

Vetëm 21.603.000 lekë janë planifikuar për investime.

Kontributi i Bashkisë në krijimin e të ardhurave është 13.800.000 lekë, pra rreth 18 % e vlerës së buxhetit. Këtë vit rritja e të ardhurave është parashikuar kryesisht nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël dhe nga disa tarifa shërbimi (zgjerim bazë jo rritje niveli).



BUJQËSIA

Gjeografikisht Bulqiza ka një strukturë terreni të tillë ku mbizotërojnë fushat e vendosura në lartësinë mbi 500 m mbi nivelin e detit. Ata zënë rreth 87.6% ose 361 ha, pjesa tjetër është reliev kodrinor dhe malor. Sipërfaqja e tokës gjithsej 5167 ha, ku nga këto: tokë bujqësore (arë, pemëtore, vreshta, truall) 2174 ha, tokë jobujqësore (inproduktive, ranishte, zallishte, ledh, livadh, kullotë, moçal) 2994 ha, pyje 1453 ha, të cilat shtrihen brenda kufijve territoriale të Bashkisë, janë kryesisht prej pishë, bredhi, ahu e dushku. Rrëzë tyre, shpesh mes tyre e sidomos në formën e kullotave alpine, gjenden kullotat natyrore. Flora natyrore në këto sipërfaqe është mjaft e pasur dhe me vlera të shumta përdorimi. Veçojmë këtu bimët medicinale, aromatike e ato me vlera industriale.

Vlen të përmendet fakti se sot sasia e sipërfaqes e konsideruar livadh (356 ha) dhe kullotë (2354 ha), shtrihet në pjesën fushore të territorit administrativ të Bashkisë Bulqizë.

Bujqësia në Bashkinë e Bulqizës është përqendruar në të vetmin fshat të kësaj njësie, Vajkal. Ashtu si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Sistemi socialist i bujqësisë (kooperativat) u çmontua dhe kjo u shoqërua me dëmtime serioze të rrjeteve ujitëse dhe kulluese, të ndërtesave që i shërbenin prodhimit bujqësor, etj. Përdorimi i burimeve bujqësore ra në mënyrë drastike, e cila solli pakësimin e prodhimit bujqësor.

Toke Bujqësore (ha)			Pyje (ha)	Livadhe kullota (ha)	Te tjera
Ara	Pemishte	Vreshta			
1609	538	-	1454	2711	-

Prodhimet më kryesore janë misri, perimet, fasulja dhe farogjeret, të cilat janë në të shumtën e rasteve për nevojat e familjeve përkatëse dhe shumë pak për në treg.

Mundësitë e evidentuara gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave me specialistët e fushës janë: krijimi i mundësisë së shtimit të sipërfaqeve me të mbjella, ndërtimi i sistemit vaditës, ndërtimi i tregut të prodhimeve bujqësore, dhënia e asistencës teknike profesionale bujqve, subvencionimi me plehra kimikë dhe pesticide, zhvillimi dhe fuqizimi i marketingut të prodhimeve bujqësore, kreditimi me interesa të ulëta të bujqve me orientim zhvillimin e kësaj dege, etj.



BLEGTORIA

Gjatë reformimit, krahas me tokën u shpërnda blegtoria dhe asete të tjera si traktorë, stalla etj. Blegtoria, ashtu si dhe bujqësia mund të konsiderohet sektori që nuk u zhvillua me ritme të shpejta gjatë tranzicionit, për arsyen e natyrës specifike të përbërjes së tokës dhe klimës së ashpër të zonës. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur, por që nuk mund të themi se janë në atë masë që familjet e kësaj njësie mund të bazohen për zhvillimin ekonomik dhe të biznesit të tyre :

Bashkia	Të imëta		Gjedhë	Shpendë
	Dele	Dhi		
Bulqizë	2000	1200	900	4000

Nga analizimi i shifrave të mësipërme rezulton se numri në total i krerëve të imëta dhe gjedhit nuk përmbush kërkesat e tregut të qytetit për prodhime blegtorale. Sipas të dhënave të marra nga sektori i DBU-Bulqizë, prodhimet blegtorale paraqiten si më poshtë:

Bashkia Bulqizë

	Mish	Qumësht	Lesh	Veze
Dhen	26 t	50 t	50 t	
Dhi	13 t	70 t		
Gjedhe	75 t	800 t		
Shpendë	3.7 t			390000

Sa më sipër, referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë, prodhimet blegtorale në një vit paraqiten si më poshtë: mish-9.7 kg/banorë, qumësht-76.6 l/banorë, vezë-32.5 kokrra/banorë. Domosdoshmërisht duhet të kihet parasysh që zhvillimi numerik i bagëtisë, duhet të shoqërohet dhe me rritjen e prodhimeve blegtorale. Megjithatë, shihet si një domosdoshmëri ngritja e një baxhoje moderne për përpunimin e produkteve blegtorale, e cila

do të bënte të mundur thithjen e prodhimeve blegtorale nga komunat F.Bulqizë dhe Zerqan. Aktualisht nuk egzistojnë pika të përpunimit të prodhimeve blegtorale dhe të gjitha këto prodhime shiten në tregun e Bulqizës të papërpunuara dhe në kushte aspak të përshtatshme.

Edhe në të ardhmen sektori i blegtorisë do të përbëjë aktivitetin më të rëndësishëm në aktivitetin prodhues bujqësor të Bashkisë. Nga problemet kryesore të zhvillimit të blegtorisë dhe që kërkojnë vëmendje mund të përmendim: përmirësimin racor, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, krijimi i kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare, rritja e numrit të krerëve në çdo fermë, përmirësimin e infrastrukturës për përpunimin dhe tregtimin e produkteve blegtorale, përshtatja e fermës së vogël për të rritur dhe blegtorinë, shtimi i sipërfaqeve me foragjere, shpenzime jo të mëdha për zhvillimin e gjësë së gjallë, mundësia për sigurimin e mbijetesës së familjes, mundësia për të siguruar të ardhura gjatë vitit etj...

II. SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURA

Komuniteti në zonat urbane dhe rurale ka një model të caktuar të nevojave kryesore: rrugë, kanalizime të ujërave të zeza, kanalizime të ujërave të bardha, sistemi i ujësjellësit, elektricitet, telefona, shërbim mjekësor, shkolla, dyqane, kushte higjieno-sanitare, etj..

Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentet që u nevojitet njerëzve në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimet. Nga pikëpamja administrative, rrjeti rrugor ka tre pronarë: Drejtoria e Rrugëve Nacionale Bulqizë, Drejtoria e Rrjetit Rrugor Rural dhe Bashkia. Territori i kësaj njësie përshkohet nga 5.4 km rrugë nacionale, pjesë e rrugës Peshkopi – Tiranë, nga 7.2 km rrugë rajonale, të cilat janë nën administrim të ndërmarrjes së rrugëve rurale dhe 23.5 km rrugë nën administrim të Bashkisë. Nisur nga struktura e këtyre akteve rrugore ato janë ndarë në rrugë asfaltobetone dhe rrugë me

bazë dheu. Duke e konsideruar faktor të rëndësishëm rrjetin rrugor, vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në rrjetin rrugor të brendshme, duke përdorur fondet e buxhetit të shtetit, donatorë të ndryshëm si dhe nga vetë Bashkia.

UJI I PIJSHËM

Furnizimi me ujë të pijshëm i komunitetit aktualisht përbën një prioritet për qeverisjen qendrore dhe atë vendore. Kjo shikohet jo vetëm në aspektin sasior, por edhe atë cilësor dhe të dy lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet. Për furnizimin me ujë të pijshëm në Bashki përdoren: furnizimi i zonës urbane të qytetit realizohet me 2 ujësjellësa me gjatësi -10.66 km rrjet kryesor dhe 18.3 rrjet shpërndarës. Ky shërbim i ofrohet çdo familje e vendosur në ndërtesa kolektive (pallate) dhe pri-

Nr	Fshati/Lagjia	Rr. nacionale		Rr.kryesore		Rr.Lagjie		Sheshe	
		asfalt	paasf	asfalt	paasf	asfalt	paasf	asfalt	paasf
1	Vajkal-1	2.5	=	2.5	=	=	3	=	0.5
2	Vajkal-2	1	=	1	=	=	9	=	0.6
3	Lagjia e Re	=	=	1.1	1.4	=	1.4	0.2	=
4	Lagjia Minatori	1.2	=	1.2	0.7	=	0.7	0.7	=
5	Lagjia Gjeologu	0.7	=	0.7	0.4	=	0.4	0.7	=
	Bashkia	5.4	=	6.5	2.5	=	14.5	1.6	1.1



Nr	Fshati/Lagjia	Prodhimi i Ujit (m3)	Kapaciteti l/s	Gjatësia e rrjetit kryesor (Km)	Gjatësia e rrjetit shpërndarës (Km)	Kap. depozitues
	Vajkal-I	4.665.600	4.5	2.5	0.5	90
	Vajkal-2	2.799.360	2.7	2.2	0.37	80
	Lagjia e Re	41.472.000	40	5.9	8	850
	Lagjia Minatori	45.619.200	44	2.7	5	600
	Lagjia Gjeologu	45.619.200	44	2.96	5.3	600
	Bashkia					

vate brenda territorit të qytetit. Ndërsa në fshatin Vajkal jo të gjithë familjet e kanë shërbimin e mësipërm në shtëpitë e tyre. Një pjesë e mirë furnizohen me ujë të pijshëm me çesma kolektive sipërfaqësore.

Zona në fjalë konsiderohet një nga zonat me resurse burimore ujore më të mëdha të rajonit, kjo falë përbërjes litologjike të shkëmbinjve dhe pozicionit gjeografik të vendosjes së vendbanimeve.

KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA

Kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha është një element i infrastrukturës që ka filluar të vlerësohet sidomos në vitet e fundit, pasi si rezultat i amortizimit shumëvjeçar, vihet re një mosfunksionim normal i tyre. Më problematike paraqitet gjendja në lagjen Minatori dhe Gjeologu, ku në shumë raste vihet re dalja e ujërave të zeza në sipërfaqe. Nga rezultatet e pyetësorit të zhvilluar në komunitet, rezulton se një pjesë e konsiderueshme nuk është e kënaqur me këtë shërbim të detyrueshëm. Grupi i punës dhe mendimi intelektual përkon në devijimin dhe përqendimin në veri të qytetit si dhe për të mundësuar trajtimin e tyre sipas standardeve bashkëkohore.

Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujërave të zeza në fshat është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre në rrugë dhe përbën problem në vetvete nga pikpamja mjedisore.

KANALIZIMI I UJËRAVE TË BARDHA

Faktikisht Bashkia Bulqizë përballet me një problem: kolektori i shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe të atyre të minierës, si rezultat i uljes së bazamentit të luginës nuk kryen largimin e plotë të ujërave. Në vetvete përbën një problem jo të vogël, pasi mbi këtë nyje shtrihet rruga nacionale Peshkopi-Tiranë, ku në anë të magjistratit ushtrojnë veprimtarinë disa biznese të kësaj njësie.

Mundësitë e kthimit të problemit të mësipërm nga një pikë e dobët në një pikë të fortë për këtë njësi

Mendime për dy variante për të ardhmen:

Varianti i I-rë

- Ndërhyrje emergjente në largimin e ujërave të zeza, kryesisht të spitalit, që derdhen në kolektorin e shkarkimit të ujërave të bardha.
- Ndërtimi i një argjinature të vazhdueshme përreth "liqenit" të Bulqizës.
- Pyllëzimi përreth tij me katër rrjeshta shelgje lotuese.
- Sistemimi dhe betonimi i rrugës nacionale që kalon mes basenit.
- Krijimi i mundësisë së lidhjes të dy pellgjeve.
- Ndërtimi i parrmakëve të drurit përbri rrugës në pjesën e dy pellgjeve.

Varianti i II-të

- Ndërtimi i linjës së impiantit të seleksionimit të sterileve të kromit në aksin rrugor Qytet – Varreza.
- "Mbathja" e gropës ujëmbajtëse me stoqet e kromit
- Rezultati: 400000 ton krom të pastër (12 milion \$) dhe punësim për 25-30 punonjës, kryesisht gra.

Nr	Fshati/Lagjia	Rrjeti kryesor	Rrjeti sekondar	Gr.septike kolektive	Gr.septike personale	Përfitues familje
	Vajkal-I	-	2	-	307	307
	Vajkal-2	-	1.8	-		
	Lagjia e Re	1.4	0.2	300		
	Lagjia Minatori	1.2	0.4	270	-	3125
	Lagjia Gjeologu	0.7	0.5	286		
	Bashkia					

MBETJET URBANE

Nga tabela e mëposhtëme vihet re se qyteti përballlet me një shqetësim të vazhdueshëm, në drejtim të pastrimit të qytetit dhe largimit të mbetjeve urbane. Gjendja në fshatin Vajkal është shumë e rëndë, pasi në asnjë rast nuk janë marrë masat e duhura për përmirësimin dhe shtimin e kujdesit ndaj mjedisit. Po ashtu, në qytet raporti 26.48 familje/një kosh kolektiv është relativisht i madh dhe në shumë raste mosfunktional. 51% e popullsisë shprehen se nuk janë të kënaqur me shërbimin e pastrimit, ndaj në të ardhmen duhet të merren masat e duhura për përmirësimin e gjendjes.



Nr	Fshati/Lagjia	Kosha kolektivë	Mb.Urb. të ngurta	Mb.Urb. të zakonshme	Përfitues familje	Raporti
	Fshat	=	70	20-30	307	307
	Qytet	118	20	40-50	3125	26.48
	Bashkia	118	90	60-80	3432	—

SHËRBIMET E TJERA

Shërbimi postar & telefonik: Shërbimet e postës dhe ato telefonike, ashtu si në të gjithë vendin nuk mungojnë. Shërbimet e postës janë të organizuara dhe realizohen nga kompania shtetërore “Posta Shqiptare” si dhe nga kompania private “Albania Ekspres”. Ky shërbim nuk është në lartësinë e duhur dhe kjo vjen nga mungesat e vazhdueshme të adresave të sakta të familjeve. Po bëhet një punë e mirë në këtë drejtim nën mbështetjen e pushtetit vendor. Do të ishte e udhës dhe përfundimtare për këtë shërbim realizimi i vendosjes së kutive postare dhe krijimi i një databesi adresash.

Shërbimi telefonik realizohet nga “Albtelekom”, “AMC-Mobil” dhe “Vodafone-Mobil”, të cilat operojnë në të gjithë tregun shqiptar. Shërbimi fiks mbulohet vetëm nga “Albtelekom” dhe në Bashkinë Bulqizë ky shërbim u ofrohet 987 familjeve ose 34.7% të tyre. Kjo shifër e ulët vjen si rezultat i politikave të ndjekura nga “Albtelekom” për mundësimin e pajisjes së familjeve me një shërbim të tillë. Aktualisht çdo familje duhet të paguajë rreth 150 Euro, për të mundësuar kontratën e këtij shërbimi me Albtelekomin.

Dy kompanitë e tjera operojnë në rrjetin Mobil (celular) dhe shërbimet e tyre i ofrojnë në të gjithë territorin e kësaj njësie. Sipas statistikave të marra në rrugë operative, rezulton se në çdo familje ky shërbim ofrohet në më shumë se një rast.

Energjia elektrike: Shërbimi i furnizimit të energjise elektrike është i shtrirë në të gjitha zonat e banuara të kësaj njësie. Rrjeti kryesor prej 12.9 km nga n/stacioni elektrik Bulqizë dhe rrjeti sekondar (tension i ulët) prej 19.1 km, garantojnë një shërbim të vazhdueshëm ndaj komunitetit.

III. ZHVILLIMI SOCIAL

PROBLEMET DHE ZHVILLIMI I ARSIMIT

Në Bashkinë e Bulqizës arsimimi realizohet nëpërmjet arsimit parashkollor, arsimit fillor, nëntëvjeçar dhe atij të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Vendosja e rrjetit të shkollave fillore dhe tetëvjeçare në zonën rurale në kushtet e një migrimi jo dhe aq të theksuar nuk përbën ndonjë risk për të ardhmen e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij shërbimi ndaj komunitetit.

Sot në këtë Bashki banon një popullsi me arsimim të kënaqshëm, kryesisht me arsim të mesëm. Vlen të theksohet se me arsim të lartë ka një numër të konsiderueshëm personash, ku mbizotërojnë specialistët e minierave dhe të shërbimit gjeologjik me rreth 24. Në Bashki numërohen 2 kopshte fëmijësh me një numër total prej 250 fëmijësh, 2 shkolla 9-vjeçare, në të cilën mësojnë 1682 nxënës dhe ka 80 mësues dhe në shkollë të mesme me 893 nxënës dhe 34 mësues. Në ambientet e shkollave të qytetit mësojnë edhe 246 nxënës nga fshati Vajkal. Problem për këta nxënës është largësia e vendbanimit të tyre me shkollën ku mësojnë,

Nr	Arsimi	Nr. nxënësve	Nr. mësuesve	Nr. klasa	Raporti Nx/Mësues	Raporti Nxënës/ Klasë	Nr.Nxënësve femra	Nr.mësuesve femra
1	Parashkollor	250	17	8	15/1	31/1	114 (45.6 %)	17 (100%)
2	CU	842	33	31	26/1	26/1	420 (49.88 %)	32 (97%)
3	9-vjecar	1682	80	60	21/1	28/1	777 (46.2 %)	69 (86.2%)
4	Mesëm	893	34	22	25/1	39/1	512 (57.33 %)	19 (55.8%)
5	Profesional	212	10	6	21/1	35.3/1	186 (87.7 %)	6 (60%)
	Bashkia	3629	157	119	23.11	30.49	1403(49.66%)	105 (80%)

problem i cili duhet të marrë rrugën e zgjidhjes në të ardhmen jo të largët, sidomos për ciklin fillor.

Nga statistikat e siguruar rezultojnë se për çdo vit numri i nxënësve në të gjithë sistemin arsimor brenda territorit të bashkisë është në rritje dhe kjo për arsye të mëposhtme: i) Lëvizjet migruese përgjithësisht deri diku janë të stabilizuara. ii) Për arsyen e nivelit të mësimdhënies vihet re një lëvizje e nxënësve nga komunat F.Bulqizë e Zërqa në drejtim të shkollave të Bashkisë. iii) Në shkollën e mesme të qytetit ndjekin mësimin nxënës pothuajse nga të gjithë komunat e rrethit. iv) Hapja e degës së re profesionale (pedagogjike), etj.

Arsimi në këtë zonë urbane në krahasim me zonat rurale ka një sërë avantazhesh, ku më kryesore mund të përmendim:

- i) Numër më të shumtë të nxënësve për një mësues;
- ii) Kosto më të ulët për një nxënës;
- iii) Mësues më të kualifikuar dhe që zhvillojnë lëndë për të cilat ka dhe specialistë;
- iv) Standarde mesatare në dhënien e mësimin dhe performancën e nxënësve;
- v) Mundësi trajnimi;
- vi) Mungesë jo të mëdha të laboratorëve dhe mjeteve didaktike të nevojshme, etj.

Në dy vitet e fundit është hapur shkolla e mesme pedagogjike, në të cilën mësojnë 212 nxënës dhe janë të punësuar 10 mësuesdhënës të përzgjedhur në të gjithë rrethin.

Nga shifrat e mësipërme vihet re se në arsimin e mesëm profesional dhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm numri i nxënësve për klasë është mbi raportin e lejuar 35 nxënës për klasë. Mendojmë se duhet parë me përparësi krijimi i ambienteve të reja për shkollën e mesme. Me qëllim përbalimit të fluksit të nxënësve nga njësitë e tjera vendore, problemi i sigurimit të ambienteve, sidomos për arsimin profesional (pedagogjike), duhet të trajtohet me prioritet për të mundësuar zhvillimin normal të arsimimit të nxënësve dhe zbatim të politikave dhe strategjive ndërsektoriale në këtë fushë. Aktualisht ky sistem operon në vitet e I-rë dhe të II-të dhe në dy vitet e

ardhshme duhet domosdoshmërisht ndërtimi i të paktën 4 klasave të reja.

Shifrave dhe raportet të marra nga DAR-Dibër dhe krahasimi i tyre me të dhënat e Bashkisë Bulqizë janë si më poshtë:

- Raporti nxënës/mësues për Shqipërinë është rreth 18.00
- Raporti nxënës/mësues për qarkun Dibër është 17.85
- Raporti nxënës/mësues për rrethin Bulqizë është 18.45
- Raporti nxënës/mësues për Bashkinë Bulqizë është 23.11

Siç vihet re, në Bashkinë Bulqizë raporti i mësipërm është në vlera më të larta dhe kjo u referohet problemeve dhe arsyeve që trajtuam më sipër.

PROBLEMET DHE ZHVILLIMI I KULTURËS & SPORTEVE

Ambientet sportive: “18 shkurti”, një datë simbolike për “qytetin e minatorëve”, por dhe një pagëzim për ekipin e futbollit të rrethit Bulqizë. Një vështrim i përgjithshëm mbi ambientet që momentalisht ofrohen për sportin në përgjithësi, lë shumë për të dëshiruar. I vetmi ambient publik është fusha e sportit e vendosur në veri të qytetit, ambient i cili nuk ka kushtet më minimale për përfaqësimin e këtij qyteti në aktivitetet kombëtare të futbollit. Më problematike paraqitet gjendja në drejtim të mungesës së dhomave të zhveshjes të sportistëve, por dhe e asaj infrastrukture për shikuesit. E gjitha kjo ka ardhur si rezultat i pamundësisë së ndërhyrjeve të mëdha të bashkisë si dhe i mungesës së interesit nga subjektet private të këtij rrethi. Fokusi i bashkisë në të ardhmen do të jetë në zhvillimin e sportit në të gjithë disiplinat e mundshme, duke siguruar efektivitet dhe krijim kushtesh për argëtimin e komunitetit.

PROBLEMET DHE ZHVILLIMI I SHËNDETËSISË

Largësia nga qendra urbane, niveli i të lëshqyerit, kushtet e jetesës në tërësi,

vështirësitë e punës në minierë në bujqësi, kushtet klimaterike të ndryshueshme me temperatura relativisht të ulëta etj., e bëjnë të domosdoshme ekzistencën e një shërbimi shëndetësor sa më të përshtatshëm dhe shërbyes për komunitetin. Sistemi shëndetësor në Bashki përbëhet nga spitali i rrethit Bulqizë i vendosur në pjesën jugore të qytetit, dy qendra shëndetësore, një ambulancë në fshatin Vajkal ku punojnë mjekë dhe infermierë, si dhe dy konsultorë “nëna dhe fëmija”.

Shërbimi shëndetësor ndeshet me probleme si: mungesë të mjekëve specialistë, mungesë të pajisjeve mjekësore, mungesë të ilaçeve, puna me kohë e reduktuar e mjekëve, etj. Repartet në spitalin e rrethit Bulqizë janë të kufizuara, përkatesisht patologjia, kirurgjia, materniteti dhe pediatria, ndërsa mungojnë shërbimet e specializuara të domosdoshme për komunitetin.

Një problem tjetër është dhe kultura lidhur me kujdesin për shëndetin. Njerëzit kërkojnë ndihmën e mjekut vetëm në raste urgjente dhe nuk i nënshtrohen kontrolleve të vazhdueshme.

Është 132 numri i përgjithshëm i personelit të këtij shërbimi, i cili kryen detyrat sipas funksioneve, ku më të shumtët në numër janë punonjësit me arsimin të mesëm, 105. 64 prej tyre ushtrojnë shërbimin e infermieres. Sa sipër vihet re një mungesë e theksuar e specialistëve mjekë dhe infermierë, mungesa të cilat kanë ardhur si rezultat i lëvizjeve demografike të popullsisë (pjesa intelektuale dhe e specializuar në shëndetësi), si dhe nga pamundësia e shkollimit të nxënësve të kësaj zone në universitetet dhe shkollat e larta profesionale.

E njëta situatë është dhe në shërbimin parësor, i cili përmbushet nga tre mjekë të përgjithshëm dhe 18 infermierë. Të rralla kanë qenë rastet e sëmundjeve ngjitëse si: hepatiti, fruthi, lija e rubéola dhe këta janë paraqitur si raste të dyshimta, pasi pretendohet se në të gjitha rastet shërbimi i vaksinimit të fëmijëve është kryer në kohën e duhur. Ky është një moment për t'u vlerësuar dhe nxjerrë shkaqet e rasteve të evidentuara.

Sektori i shëndetësisë përballet dhe me një sërë problemesh të tjera, të cilat në vetvete përbëjnë dhe pikat më të dobëta të këtij shërbimi, të cilat janë:

- i) Mungesa e pajisjeve mjekësore,
- ii) Kushte jo të përshtatshme të godinës së spitalit;
- iii) Mungesa e një qendre shëndetësore në fshatin Vajkal;
- iv) Mungesa e kapaciteteve profesionale, përfshi këtu mjekët dhe infermierët, etj.



BURIMET NATYRORE

Bulqiza ka sipërfaqe të konsiderueshme me pyje si: ah, pishë, bredh dhe me livadhe, e cila ka një bukuri natyrore mbresëlënëse. Ata ndikojnë pozitivisht në mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe në të njëjtën kohë sigurojnë lëndë drusore për djegie, ndërtim etj. Në këto pyje rriten shumë bimë medicinale si: dëllinja, trëndafili i egër, çaji i malit, lule bliri, zhumblica, mëllaga, lule basani, lule shtogu etj.

Pyjet e larta janë në gjendje relativisht të mirë, ndërsa korijet dhe pyjet shkurre janë dëmtuar seriozisht nga prerjet e pakontrolluara, duke sjellë rritjen e shkallës së erozionit dhe probleme të tjera të ambientit. Bashkia Bulqizë ka burime natyrore të pasura e të shumëllojshme. Duke ofruar një peisazh të bukur kryesisht malor, me pyje të shumtë e kullota masive, me ujëra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, me masive shkëmbore që i japin variacion në formë e në ngjyrë këtij peisazhi, kjo natyrë e begatë, të fton e të bën optimist për mundësitë e zhvillimit turistik të kësaj njësie.

KROMI

Miniera më e madhe është ajo e Bulqizës, ku ndodhen rreth 41% e rezervave (fig. 2). Ky vendburim kromi ka filluar nga aktiviteti në vitin 1948 në daljet sipërfaqësore e në vazhdim e gjithë hapja e shfrytëzimi është bërë e bëhet me anën e punimeve sipërfaqësore e nëntokësore.

TË DHËNA PËR FUQINË PUNËTORE

Industria e kromit ka punësuar gjithmonë një numër të konsideruar punonjësish, siç mund



të shihet në figurën poshtë. Pjesa më e madhe e tyre i takon qarkut të Dibrës.

Pas procesit të privatizimit, numri i punëtoreve u reduktua shumë. Një pjesë e madhe e tyre përfituan nga ligji që u jepte të drejtën vetëm minatorëve për dalje në pension pas plotësimit të një periudhe pune dhe disa kushteve të tjera si puna në nëntokë etj. Gjithashtu, në bazë të ligjit, në gusht të vitit 2001, rreth 824 punonjës të qarkut të Dibrës u shkurtuan si rezultat i dhënies me koncesion të minierës së Bulqizës etj. Në këtë rast kompania koncesionare “Darfo Albania” sh.p.k. pagoi për secilin prej tyre një vlerë të barabartë me pagën e dy viteve pune, gjithsejt 248 milion lekë. Të shkurtuarit gëzuan edhe të drejtën e 1 viti asistencë.

Aktualisht, në qarkun e Dibrës punojnë në sektorin minerar rreth 1100 punonjës, (fig 10) nga të cilët 879 janë të punësuar në koncesionin e kompanisë “Darfo Albania” sh.p.k. (684 në Minierën e Bulqizës, 105 në Uzinën e ferrokromit Burrel, 90 në fabrikën e pasurimit Bulqizë dhe Impiantin e Klosit). Rreth 200 - 250 punonjës të tjerë janë të punësuar në 60-70 aktivitete minerare të tjera private në këtë rajon.

Aktualisht qarku i Dibrës është zona më e suksesshme minerare në vendin tonë. Industria e kromit në këtë zonë po zhvillohet me shpejtësi nisur edhe nga rezervat gjeologjike dhe cilësinë mjaft të mirë të mineralit. Sipas parashikimeve do të ketë një rritje të konsiderueshme të investimeve.

PROBLEME

Sektori minerar në përgjithësi është një sektor mjaft i vështirë për t’u zhvilluar për arsye të nevojës për investime të konsiderueshme.

Procesi i kthimit të investimeve është i ngadalshëm dhe mjaft i vështirë për t’u përballuar nga privatët e vegjël. Megjithatë duhet thënë se tregu i favorshëm ka bërë që industria e kromit të ketë një zhvillim të kënaqshëm për momentin. Nëpërmjet kredive të vogla e të mesme, mjaft nga minierat e vogla kanë rritur investimet dhe kanë zgjeruar prodhimin, sidomos të kromit të pasur, për të cilin shquhet qarku i Dibrës. Egzistenca e dy uzinave metalurgjike të kompanisë “Darfo Albania” (në Burrel dhe Elbasan) ka krijuar një treg të brendshëm mjaft aktiv në ndihmë të minierave të vogla.

Pavarësisht nga sa më sipër, sektori minerar për vetë vështirësitë tepër specifike të tij ka nevojë për kujdes më të madh nga ana e shtetit. Kryesore mbetet çmimi i energjisë elektrike, i cili shitet nga KESH sh.a. (8.4 lek/këh) me dyfishin e çmimit të tregut rajonal të energjisë. Ky fakt ndikon negativisht në mekanizimin e minierave dhe futjen e sistemeve moderne të shfrytëzimit dhe po nuk u korrignua në kohën e duhur do të ndikojë ndjeshëm në falimentimin e një sërë prodhuesve të vegjël dhe mund të sjellë largimin e prodhuesve të mëdhenj koncesionarë të industrisë sonë minerare.

Një tjetër problem për këtë sektor mbetet gjendja shumë e vështirë e rrugëve të transportit të mineralit deri në portin e Durrësit si edhe infrastruktura e vetë portit.

IV. QEVERISJA E MIRË

QENDRA E INFORMIMIT PUBLIK

Një nga problemet e evidentuara në këtë bashki, si shqetësim i të gjithë grupit të punës, është mungesa e sistemit të informimit qytetar. Parimisht duhet të operohet që në qelizat fillestare të sistemit, si: ngritja e një zyre të informimit publik, pajisjen e saj me mjetet elektronike të domosdoshme, ngritja dhe ndërtimi i stendave të informimit, trajnimi i punonjësve të informimit, publikimi i buletinit të bashkisë etj.

QENDRA KULTURORE

Ambientet kulturore: Bashkia Bulqize por dhe arrethi, pothuajse të gjitha aktivitetet kulturore i zhvillon në shtëpinë e kulturës, e cila është nën administrimin e kësaj njësie. Salla e shfaqjeve është e kompletuar me të gjitha kushtet dhe ofron mundësi të mira për paraqitjen e vlerave të kësaj treve të verilindjes. Gjithashtu, në ambientet e kësaj qendre gjenden dhe janë funksionale dy salla për kurse profesionale për grupet e



interesuara, një sallë kompjuterësh, ku përveç mësimet të tij janë funksional për shërbimin e internetit për komunitetin, si dhe një sallë takimesh me rreth 35 persona.

Eshtë për t'u përmendur se në Bashkinë Bulqizë operojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre një sërë grupesh komunitare (OJF), shoqata, grupe rinore, sportive dhe kulturore, të cilat edhe pse përballen me plot vështirësi, ndikojnë në gjallërimin e jetës kulturore të këtij qyteti. QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit), FPG (Forumi i Pavarur i Gruas), Kryqi i Kuq, SHKD (Shoqata për Kulturë Demokratike), Shoqata Martaneshi, Shoqata e Invalidëve të Punës, Shoqata e Gjuetarëve, Shoqata në dobi të gruas bulqizake, Shoqata e Gjeologëve, Grupet Rinore, Qendra Kulturore për Fëmijë, Qeveritë e nxënësve etj., po rritin aktivitetin e tyre dita-ditës dhe gjithmonë e më tepër po bëhen një zë i së ardhmes dhe pararojë e ndryshimeve të sigurta për një qytet të përparuar. Bashkëpunimi i OJF-ve me pushtetin lokal për problemet që kanë në fokus rininë, gruan dhe grupet e tjera shoqërore. Ngritja e një qendre sociale shërbimesh për gratë, vajzat, të rinjtë. Organizimi i aktiviteteve me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor të Bulqizës.

PRIORITETET E PROCESIT

- 1- Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore Bulqizë
- 2- Hartimi i planit rregullues dhe urbanistik të qytetit
- 3- Ndërtimi i një shkolle të re për arsimin profesional së bashku me konviktet
- 4- Ndërtimi i tregut të qytetit
- 5- Hapja e zyrës së komunikimit
- 6- Ndërtimi i fushës së mbetjeve urbane
- 7- Rikonstruksioni i zyrave të bashkisë
- 8- Ndërtimi i një këndi lojrash dhe vende pushimi
- 9- Përmirësimi i shërbimit të pastrimit
- 10- Përmirësimi i magjstralit të ujërave sipërfaqësor
- 11- Riparimi i fasadave të qytetit
- 12- Asfaltimi i segmentit rrugor mes dy qyteteve
- 13- Ndriçimi rrugor i lagjeve të qytetit
- 14- Kompjuterizimi i zyrave të administratës së bashkisë
- 15- Asfaltimi i rrugëve sekondare
- 16- Rikonstruksioni i kopshteve dhe furnizimi me materiale didaktike
- 17- Hartimi dhe publikimi i guidës turistike
- 18- Ndërtimi i një thertorje bashkëkohore
- 19- Shtimi i koshave kolektivë në lagjet e qytetit
- 20- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta
- 21- Transporti urban mes dy qyteteve
- 22- Publikimi i gazetës informative të bashkisë
- 23- Ndërtimi i muzeut të qytetit
- 24- Ndërtimi i një qendre shëndetësore në Vajkal
- 25- Ngritja e laboratorëve të shkencave natyrore në shkolla
- 26- Rikonstruksioni i godinave të shkollave të qytetit
- 27- Mbrojtja e tokave nga erozioni
- 28- Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit
- 29- Rikonstruksioni i përgjithshëm i spitalit
- 30- Mirëmbajtja e varrezave publike
- 31- Ndërtimi i ambienteve sportive dhe palestrave për shkollat e qytetit
- 32- Mbrojtja e burimeve të tjera natyrore ujore, shtazore dhe bimët
- 33- Mirëmbajtja e objekteve të kultit dhe atyre historike
- 34- Ndërtimi i kompleksit për riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake
- 35- Sigurimi i veshjeve dhe instrumentave të zonës
- 36- Ngritja e stendave të informimit në bashki

- | | |
|---|--|
| 37- Rikonstruksioni i bibliotekës | bashkëkohore |
| 38- Sistemimi i shesheve dhe rrugëve brenda lagjeve | 42- Futja e sinjaleve të TV-Kombëtare |
| 39- Ndërtimi i konviktit për nxënësit | 43- Vaksinimi i popullsisë |
| 40- Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza | 44- Promovimi i trashgimisë kulturore |
| 41- Furnizimi i spitalit me aparatura | 45- Rehabilitimi i kanalizimeve të ujërave të bardha |
| | 46- Sigurimi i transportit për nxënësit |

VIZIONI

Bulqiza, do të jetë një qytet me infrastrukturë bashkëkohore, me njerëz të arsimuar dhe të shëndetshëm, me ekonomi të zhvilluar e shërbime cilësore, me komunitet të punësuar e me mundësi argëtimi dhe turizmi

Fusha prioritare: ZHVILLIMI EKONOMIK

Ekonomia e Bashkisë sonë është mbështetur në zhvillimin e përgjithshëm në drejtim të punësimit të komunitetit, zhvillimin e tregut dhe të shërbimeve të tregtisë, përmirësimin e blegtorisë si dhe krijimi i mundësive për ekoturizëm. Për vetë natyrën e saj, duke mos pasur një orientim të vetëm zhvillimi, harmonizimi i të gjitha fushave dhe gjetja e mundësive reale për krijimin e klimës për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social në të gjithë sferat e jetës përbën një nga alternativat e vetme parë kjo në këndvështrimin e së ardhmes.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: Zhvillimi i blegtorisë

Zhvillimi i blegtorisë, si një mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës duhet të shikohet me prioritet. Mundësia e zhvillimit të saj është pasi zona e Bulqizës disponon fusha të tëra, të cilat sot nuk përdoren për aktivitete të tjera. Zhvillimi i kësaj fushe duhet të përqendrohet në pjesën rurale të bashkisë, Vajkal. Për këtë duhet inkurajimi i komunitetit dhe ndjekja e politikave të duhura, pasi mundësitë e tregut të brendshëm janë dhe marketingu do të siguronte një zhvillim të qëndrueshëm.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: Zhvillimi i biznesit të vogël

Bashkia do të mbështesë individët, subjektet vendase apo të huaja, të cilat planifikojnë të ngrenë biznese të përpunimit të produkteve blegtoriale dhe bujqësore, rrobaqepsi, të zhvillojnë industrinë e përpunimit të bimëve medicinale, aromatike dhe atyre industriale,

duke përdorur si krahë pune burimet njerëzore në Bashki kryesisht gratë. Organizimi dhe përqendrimi i tregut do të përbënte një prioritet në këtë drejtim.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Zhvillimi i industrisë energjitike

Zhvillimi i industrisë energjitike nëpërmjet futjes së investimeve nga donatorë të huaj dhe kompani vendore të cilat bëjnë të mundur instalimin e impianteve të erës për prodhimin e energjisë alternative. Përshkrimi i zonës së Bulqizës nga erëra të forta përbën një alternativë për përfshirjen në programet qeveritare për ndërtimin e motogeneratorëve të erës, të cilët do t'i jepnin bukuri dhe mundësi turistike. Gjithashtu, një alternativë tjetër është shfrytëzimi i burimeve ujore për ndërtimin e HEC-eve të vegjël.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Zhvillimi i Ekoturizmit

Zhvillimi i ekoturizmit është mbështetur mbi përmirësimin e strukturave turistike ekzistuese, duke investuar për përshtatje të ambienteve për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxitja e turizmit rural, turizmit të gjetisë, alpinizmit me grupe të vogla, me tenda, qendra fjetje në pika tërheqëse si në liqenet e Dhoksit, si dhe duke tentuar në afatgjatë në ngritjen e stacioneve dimërore komplekse me struktura të mëdha të shoqëruara me aktivitete promovionale nëpërmjet reklamave, panairove dhe informimit.

FUSHA PRIORITARE: ZHVILLIMI EKONOMIK		STRATEGJI DHE PLANE KOMBETARE DHE RAJONALE QE NDIKOJNE NE KETE FUSHE PRIORITARE
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1. Zhvillimi i Blegtorisë 2. Zhvillimi i biznesit të vogël 3. Zhvillimi i industrisë energjitike 4. Zhvillimi i e Ekoturizmit	1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit e Integritimit 2. Strategjia rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Dibrës 3. Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin 4. Strategjitë ndërsektoriale
Projektet/plani i veprimit		Koha e realizimit
1.	Zhvillimi i blegtorisë	
	1. Rritja e numrit të krrerëve dhe strukturës së bagëtive që mund të përballojë kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjere.	Vazhdimisht
	2. Vaksinimi i përgjithshëm i kafshëve në të gjithë bashkinë.	Vazhdimisht
	3. Ndërtimi i punës për përmirësimin racor si dhe ruajtjen e llojeve të vendit.	Vazhdimisht
	4. Inkurajimi nëpërmjet kreditimit të individëve për ngjitjen e një njësie për përpunimin e produkteve blegtorale.	Vazhdimisht
2.	Nxitja e biznesit të vogël dhe të mesëm	
	2.1. Studimi i tregut dhe inkurajimi i investitorëve privatë për hapjen e një reparti për prodhimet artizanale. Kontraktim me subjektet private vendase dhe të huaja prodhuese të konfeksioneve, si dhe identifikimi i tregjeve përkatëse të prodhimeve artizanale.	Vazhdimisht
	2.2. Mbështetja e bizneseve ekzistuese të përpunimit të drurit duke ju krijuar kushte lehtësuese për zhvillimin e tyre.	2008-2013
	2.3. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për zhvillimin e biznesit për grumbullimin, manipulimin dhe tregtimin e bimëve medicinale, aromatike dhe industriale.	2008
	2.4. Ndërtimi i një tregu të ri bujqësor, blegtoral, artikuj konfeksione dhe artizanale. Kosto: 26.800.000 leke	2008-2010
3.	Zhvillimi i industrisë energjitike	
	1. Nxitja për ndërtimi i impianteve të erës dhe përqendrimi i tyre në kodrat e Qafës së Buallit si dhe në veri të qytetit	2008-2013
	2. Kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Energjitikës për sigurimin e implementimin e projektit.	2008-2009
	3. Ofrimi i mundësive biznesit vendas për ndërtimin e Hec-eve të vegjël për prodhimin e energjisë elektrike në Dhoks.	2009

Projektet/plani i veprimit	Koha e realizimit
4. Zhvillimi i ekoturizmit	
4.1. Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në tërësi, ndërkohë që restorantet në Bulqizë kanë krijuar profilin e tyre me asortimentet e gatimit që janë tipike dhe karakteristike për zonën tonë.	Vazhdimisht
4.2. Përpilimi i një guide turistike për Bashkinë tonë ku të evidentohen vlerat më të spikatura të kulturës, traditës dhe natyrës tonë të bukur dhe të pasura.	2008- 2009
4.3. Ngritja e një këndi botanik ku të pasqyrohet pasuria e madhe bimore e zonës tonë.	2008
4.4. Ndërtimi i një kompleksi turistik pranë liqeneve të Dhoksit.	2008-2009

OBJEKTIVI 1: ZHVILLIMI I BLEGTORISË

Zhvillimi i blegtorisë synon rritjen e prodhimeve blegtorale nëpërmjet shtimit të krerëve dhe strukturës së bagëtive dhe që mund të përballohen nga kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjere. Pastrimi dhe përmirësimi racor me tendencë ruajtjen e llojit të vendit do të jetë subjekt i vazhdueshëm i kujdesit të specialistëve të fushës.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
1.1 Rritja e numrit të krerëve dhe strukturës së bagëtive që mund të përballojë kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjere.	<ul style="list-style-type: none"> Propagandimi i nismës për rritjen e numrit të bagëtive dhe produkteve blegtorale në Bulqizë Sigurimi me material racor për fshatin Vajkal 	2008, në vazhdim
1.2. Vaksinimi i përgjithshëm i kafshëve në të gjithë bashkinë.	<ul style="list-style-type: none"> Gjurmimin e sëmundjeve infektive e të tjera. Bashkëpunim i vazhdueshëm me programet financuese të MBU-së dhe Drejtoritë Rajonale të bujqësisë dhe ushqimit 	2008, në vazhdim
1.3. Ndërtimi i punës për pastrimin racor me tendencë që të ruajmë llojet e vendit.	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një marrëveshje afatgjatë në bashkëpunim me Stacionin e Blegtorisë. Ndërgjegjësimi i komuniteti në lidhje me këto marrëveshje 	2008, në vazhdim
1.4. Inkurajimi nëpërmjet kreditimit ose financime private të individëve të interesuar për ngritjen e një njësie për përpunimin e produkteve.	<ul style="list-style-type: none"> Propagandimi mbi nevojën, mundësinë dhe mbështetjen për ndërtimin dhe funksionimin e një njësie për përpunimin e produkteve blegtorale. Bashkia do të kontaktoj dhe të ndërhyj në agjensi kredituese siç janë MBU, 2KR, PSHB, Fondacioni i Financimit të Zonave Malore, MADA etj. 	2008, në vazhdim

OBJEKTIVI 2: NXITJA E BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Bashkia do të mbështesë individët, subjektet vendase apo të huaja, të cilat planifikojnë të ngrenë biznese të përpunimit të produkteve blegtorale dhe bujqësore, rrobaqepësi, të zhvillojnë industrinë e përpunimit të bimëve medicinale, aromatike, dhe atyre industriale, duke përdorur si krahë pune burimet njerëzore në Bashki, kryesisht gratë. Organizimi dhe përqendrimi i tregut do të përbente një prioritet në këtë drejtim.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
2.1. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për zhvillimin e biznesit për grumbullimin, manipulimin dhe tregtimin e bimëve medicinale, aromatike dhe industriale.	<ul style="list-style-type: none"> Propagandimi i burimeve natyrore dhe nxitja e interesit të individëve dhe subjekteve private; Lehtësimi i iniciativave private 	2008

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
2.2. Studimi i tregut dhe inkurajimi i investitorëve privat për hapjen e një reparti për prodhimet artizanale. Kontraktim me subjektet private vendase dhe të huaja prodhuese të konfeksioneve, si dhe identifikimi i tregjeve.	<ul style="list-style-type: none"> Studimi i prefizibilitetit për të parë mundësitë e realizimit Bashkëpunimi dhe kontaktim i vazhdueshëm me Dhomën e Tregtisë dhe Këshillin e Qarkut për të nxitur sipërmarrjen private në këtë drejtim. 	2008-2009 2009-2013
2.3. Mbështetja e bizneseve ekzistuese të përpunimit të drurit, duke ju krijuar kushte lehtësuese për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me bankat kredihënëse, për të krijuar kushte dhe lehtësuar zhvillimin e këtyre bizneseve. 	2008-2013

OBJEKTIVI 3: ZHVILLIMI I INDUSTRISE ENERGJITIKE

Zhvillimi i industrisë energjitike nëpërmjet futjes së investimeve nga donatorë të huaj dhe kompani vendore të cilat bëjnë të mundur instalimin e impianteve të erës për prodhimin e energjisë alternative. Përshkrimi i zonës së Bulqizës nga erëra të forta përbën një alternativë për përfshirjen në programet qeveritare të ndërtimit të motogjeneratorëve të erës të cilet do t'i jepnin përveç energjisë bukuri dhe mundësi turistike. Gjithashtu, një alternativë tjetër është shfrytëzimi i burimeve ujore për ndërtimin e HEC-eve të vegjël.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
Nxjtja për ndërtimin e impianteve të erës dhe përqendrimi i tyre në kodrat e Qafës së Buallit si dhe në veri të qytetit të Bulqizës	<ul style="list-style-type: none"> Propogandimi i nismës për ndërtimin e impianteve të erës për prodhimin e energjisë elektrike. Ofrimi i mundësisë së donatoreve, duke krijuar kushtet e duhura për sigurimin e terreneve nëpërmjet praktikave ligjore të shpronësimit 	2009-2013
Nxjtja për ndërtimin e impianteve të erës dhe përqendrimi i tyre në kodrat e Qafës së Buallit si dhe në veri të qytetit të Bulqizës	<ul style="list-style-type: none"> Kontakte të vazhdueshme me METE, për sigurimin e projektit, parë kjo në dy drejtime: <ol style="list-style-type: none"> Prodhimi i energjisë dhe krijimi i mundësive për një terren turistik. 	2009
Ofrimi i mundësive biznesit vendas për ndërtimin e Hec-eve të vegjël për prodhimin e energjisë elektrike.	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i hartës së burimeve dhe sigurimi i të dhënave për kapacitetet e ujërave sipërfaqësor dhe shfrytëzimin e tyre për ndërtimin e Hec-eve. Sigurimi i partnerëve nga biznesi për investimin në fushën e prodhimit të energjisë. 	2008-2009

OBJEKTIVI 4: ZHVILLIMI I EKOTURIZMIT

Zhvillimi i ekoturizmit është mbështetur mbi përmirësimin e strukturave turistike ekzistuese, duke investuar për përshtatje të ambienteve për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxjtja e turizmit rural e agroturizmit, turizmit të gjuetisë, alpinizmit me grupe të vogla, me tenda, qendra fjetje në pika tërheqëse si në Dhoks dhe Balgjaj si dhe duke tentuar në të ardhmen afatgjatë në ngritjen e stacioneve dimërore komplekse me struktura të mëdha të shoqëruara me aktivitete promovionale nëpërmjet reklamave, panairëve dhe informimit.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
4.1. Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në tërësi, ndërkohë që restorantet në Bulqizë kanë krijuar profilin e tyre me asortimentet e gatimit që janë tipike dhe karakteristike për zonën tonë.	<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i burimeve për kualifikime dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në trainime për ata banorë që zotërojnë restorante apo që kanë ndërmend të fillojnë ose të përmirësojnë një biznes të tillë. 	2013

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
4.2. Përpilimi i një guide turistike për Bashkinë Bulqizë, ku të evidentohen vlerat më të spikatura të kulturës, traditës dhe natyrës tonë të bukur dhe të pasur.	<ul style="list-style-type: none"> • Explorimi i mundësive për financimin e bërjes së guidës (Njësia Trajnuese, Këshilli i Qarkut, etj...) • Identifikimi i aktorëve të mundshëm për t'u përfshirë në hartimin e guidës (historian, fotograf, gjeograf, etj...) 	2008-2009
4.3. Ngritja e një këndi botanik, ku të pasqyrohet pasuria e madhe bimore e zonës tonë.	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i hapësirës ku mund të krijohet këndi botanik • Kontaktimi me Departamentin e Biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 	2008
4.4. Ndërtimi i një kompleksi turistik pranë liqeneve të Dhoksit	<ul style="list-style-type: none"> • Studimi i prefizibilitetit • Kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut dhe donatorë të ndryshëm për mundësi financimi. 	2008-2009

Fusha P

Fusha prioritare: **INFRASTRUKTURA / SHËRBIMET PUBLIKE**

Përmirësimi i infrastrukturës në bashkinë tonë do të fokusohet kryesisht në drejtim të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, përmirësimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimit të ujërave të zeza, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së kanalave vaditëse dhe atyre kulluese, mbrojtjes së mjedisit, duke u kushtuar rëndësi të veçanta mbrojtjes së pyjeve nga zjarr si dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni. Në të njëjtën kohë rëndësi e veçantë i kushtohet studimit të planit rregullues për Bashkinë, i cili do të ndihmojë në të njëjtën kohë edhe zhvillimin e infrastrukturës, duke krijuar kështu lehtësira. Prioritet i jepet dhe përmirësimit të shërbimeve të tjera publike, siç janë telekomunikacioni, shërbimi i pastrimit...etj.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: *Përmirësimi dhe Mirëmbajtja e Rrjetit Rrugor*

Në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor prioritet është asfaltimi i segmentit rrugor kryesor si dhe riparimi i rrugëve dytësore nga akset kryesore në ato të lagjeve dhe fshatit Vajkal. Një rëndësi të madhe do t'i kushtohet sistemit të trotuareve brenda qytetit. Në çdo projekt do të kihen parasysh realizimi i të gjitha punimeve nënstrukturore.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: *Hartimi i Planit Rregullues*

Sistemimi i territorit të Bashkisë përfshin hartimin e planeve rregulluese për çdo lagje të bashkisë, caktimi i vendeve të depozitimit të mbeturinave familjare, plehut organik në fshat, si dhe azhurnimin e rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, të ujësjellësit, elektrik).

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: *Përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimi i ujërave të zeza*

Duke qenë një komunë me potenciale për zhvillimin e turizmit, një nga prioritetet e Bashkisë Bulqizë është edhe përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe atij të ujërave të zeza. Kjo do të realizohet nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të ujësjellësive dhe përmirësimit të atyre ekzistues si dhe kanalizimit të ujërave të zeza në bashki, duke i kaluar ato në afërsi të fushës së futbollit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Mbrojtja e mjedisit

Bulqiza ka sipërfaqe të konsiderueshme të zhveshura nga pyjet që ndikojnë negativisht në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye mbrojtja e mjedisit do fokusohet kryesisht në shtimin e pyjeve si dhe në mbrojtjen e burimeve të tjera natyrore si: burime ujore, bimët e kafshët e rralla.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike

Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike përfshin përmirësimin e shërbimit të pastrimit, përmirësimin e shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar, si dhe mbulimi i gjithë territorit të Bashkisë me përsëritës televiziv për stacionet kombëtare televizive, krijimi i një sistemi transporti të rregullt mes dy qyteteve krijimi i pikave të riparimit të orendive elektro-shtepiake, mirëmbajtja e varrezave publike etj..

FUSHA PRIORITARE: Infrastruktura/ Shërbimet Publike		STRATEGJI DHE PLANE KOMBETARE DHE RAJONALE QE NDIKOJNE NE KETE FUSHE PRIORITARE	
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor 2. Hartimi i planit rregullues 3. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, vaditës dhe kanalizimi i ujërave të zeza 4. Mbrojtja e mjedisit 5. Përmirësimi i Shërbimeve të tjera Publike	1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit e Integritimit 2. Strategjia rajonale e Zhvillimit për Qarkun Dibër 3. Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin	
	Hapat veprimit	Koha e realizimit	Kosto e përafërt
1.	1. Asfaltimi i segmentit rrugor kryesor mes dy qyteteve dhe aksi i qytetit të vjetër	2009-2011	85.000.000
	2. Riparimi i rrugëve dytësore të lagjeve dhe fshatit Vajkal	2008-2013	37.500.000
	3. Sistemimi i rrugëve brenda lagjeve të qytetit	2008-2013	78.800.000
2.	1. Hartimi i planeve rregullues për çdo lagje të bashkisë	2008	2.500.000
	2. Azhurnimi i rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, të ujësullësit, elektrik).	2009	4.800.000
	3. Ndërtimi i vendeve të depozotimit të mbeturinave familjare si dhe të plehut organik në fshat	2008-2009	1.500.000
	4. Ndërtimi i fushës së mbetjeve urbane për bashkinë Bulqizë dhe ndoshta dhe për komunat përreth	2010	34.000.000
3.	1. Rikonstruksioni i rrjetit të ujësullësive dhe përmirësimi i atyre ekzistues	2008-2010	43.200.000
	2. Kanalizimi i ujërave të zeza në Lagjen e Re dhe devijimi i tyre në afërsi të fushës së sportit	2009	5.280.000
	3. Ndërtimi i kanalit vaditës Zona D-L. Allmete	2010	6.600.000
4.	1. Shtimi i sipërfaqeve të pyllëzuara	Vazhdimisht	1.200.000
	2. Mbrojtja e tokave nga erozioni.	Vazhdimisht	9.700.000
	3. Mbrojtja e burimeve të tjera natyrore si: Burime ujore, bimët e kafshët e rralla	Vazhdimisht	2.400.000
5.	1. Organizimi i shërbimit të pastrimit nëpërmjet grumbullimit, largimit të tyre.	Vazhdimisht	15.000.000
	2. Përmirësimi i shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar.	Vazhdimisht	000.000
	3. Mbulimi i gjithë territorit të bashkisë me përsëritës televiziv për stacionet kombëtare televizive.	Vazhdimisht	000.000
	4. Krijimi i një sistemi transporti të rregullt mes dy qyteteve	2008	10.000.000
	5. Krijimi i pikave të riparimit të orendive elektro-shtepiake.	2009	6.000.000
	6. Mirëmbajtja e varrezave publike të Bashkisë së Bulqizës	2010	6.000.000

OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI DHE MIRËBAJTJA E RRJETIT RRUGOR

Në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor prioritet është asfaltimi i segmentit rrugor kryesor si dhe riparimi i rrugëve dytësore nga akset kryesore në ato të lagjeve dhe fshatit Vajkal. Një rëndësi të madhe do t'i kushtohet sistemimit të trotuareve brenda qytetit. Në çdo projekt do të kihet parasysh realizimi i të gjitha punimeve nënstrukturore.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
1. Asfaltimi i segmentit rrugor kryesor mes dy qyteteve dhe aksi i qytetit të vjetër	<ul style="list-style-type: none">• Vlerësimi i gjendjes. Është një linjë e shkurtër me intensitet rreth 500 makina /ditë• Projekti teknik - Ka projekt teknik të hartuar nga Zyra e Urbanistikës• Përcaktimi i mekanizmit të financimit - Buxheti shtetit+Donatorë• Prokurimi dhe ndërtimi: Bashkia Bulqizë	2008 2008 2009-2011
2. Riparimi i rrugëve dytësore të lagjeve dhe fshatit Vajkal	<ul style="list-style-type: none">• Vlerësimi i gjendjes. Janë akse rrugore relativisht të shkurtra• Projekti teknik - Ka projekt teknik të hartuar nga Zyra e Urbanistikës• Prokurimi dhe ndërtimi: Bashkia Bulqizë	2008 2009-2013
3. Sistemimi i rrugëve brenda lagjeve të qytetit.	<ul style="list-style-type: none">• Vlerësimi i gjendjes. Një pjesë e tyre është me bazë dheu• Projekti teknik - Ka projekt teknik të hartuar nga Zyra e Urbanistikës• Prokurimi dhe ndërtimi: Bashkia Bulqizë	2008 2009-2013

OBJEKTIVI 2: SISTEMIMI I TERRITORIT TË BASHKISË

Sistemimi i territorit të Bashkisë përfshin hartimin e planeve rregullues për çdo lagje të bashkisë, caktimin e vendeve të depozotimit të mbeturinave familjare si dhe të plehut organik në fshat, e azhurnimin e rrjetit inxhinierik (rrjeti i k. të ujërave të zeza, të ujësjellsit, elektrik).

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shenime	Deri ne vitin:
1. Hartimi i planeve rregullues për çdo lagje të Bashkisë	<ul style="list-style-type: none">• Vlerësimi i gjendjes -Për gjendjen e tanishme përbën prioritet• Përcaktimi i mekanizmit të financimit - Bashkia Bulqizë+Donatorë• Partnerët: Administrata e Bashkisë dhe organizata të specializuara	2008
